

Tregtia e mallrave industriale me Bashkimin European

**Përgatitur nga
MBA. Neritana Begaj
Menaxhere e Qendrës Burimore
Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT)**

Ky material është përgatitur për tryezën e diskutimit me temë: “Shqipëria dhe Bashkimi European – Zona e Re e Tregtisë së Lirë”

Ky aktivitet është organizuar nga ACIT me mbështetjen financiare të USAID dhe Fondacionit Gjerman Friedrich Ebert.

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucionit ku punon dhe donatorëve mbështetës të këtij projekti.

Tiranë, Nëntor 2004

Tregtia e mallrave industriale me Bashkimin Evropian

1. Hyrje

Tregtia e mallrave industriale është vetëm një pjesë e tregtisë që Shqipëria kryen me partnerët e saj tregtarë. Në mungesën e prodhimit vendas të produkteve industriale, importi i këtyre mallrave zë një peshë të mirë në flukset tregtare. Këto importe kanë rëndësi të madhe për plotësimin e nevojave për konsum të brendshëm, por edhe impakt në fuqizimin apo dobësimin e aftësisë konkurruese të prodhuesve vendas, të cilët të përballur me konkurrencën e produkteve evropiane reagojnë duke rritur produktivitetin ose duke falimentuar.

Ky treg përgjithësisht ka qenë i hapur dhe parashikohet të hapet akoma më shumë deri në liberalizim të plotë në 2009 në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit të Shqipërisë me BE. Ndërsa prej disa vitesh, BE i kishte akorduar Shqipërisë një regjim asimetrik tregtar (pra preferenca në BE për shumë produkte shqiptare industriale, por jo për produktet evropiane që hyjnë në Shqipëri), marrëveshja e re parashikon një regjim simetrik, sipas të cilit Shqipëria liberalizon hyrjen e produktet evropiane në tregun shqiptar. Proçesi i liberalizimit të tregtisë tashmë është një proçes i paevitueshëm, në të cilin janë përfshirë edhe vendet e tjera të rajonit. Por çfarë duhet të dijë biznesi shqiptar për këtë marrëveshje? Si duhet ai të sillet në kushtet e reja të tregtisë me BE që parashikon ajo?

Materiali në vazhdim synon të informojë publikun mbi këto zhvillime dhe të theksojë në mënyrë të herëpashershme nevojën për njohje dhe zbatim të rregullave të lojës së tregtisë që ka filluar dhe po bëhet gjithnjë e më sfiduese.


2. Vështrim mbi flukset tregtare të mallrave industriale me BE

Në mallrat industriale bëjnë pjesë mallrat e kapitujve 25 deri 97 të Sistemit të Harmonizuar, përveç produkteve të Aneksit I të Marrëveshjes së Buqësisë (manitol, sorbitol, lëndët albuminoide, lëkurët, gëzofët e papërpunuar, mëndafshi, leshi, pambuku).

Pothuajse e gjithë tregtia e këtyre mallrave është kryer me vendet e BE (shih Grafiku 1). Eksporti ka qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel (90% deri në 96%) duke dëshmuar për një dominim absolut të eksporteve shqiptare¹ në tregun e BE, ndërkohë që importet janë zvogëluar (nga 85% në 1998 në 73% në 2003). Rënia e importeve shpjegohet kryesisht me rënien e importit të produkteve energjitike nga burime jo-komunitare.

¹ Për vitin 2003, përpunimi aktiv ka zënë 77.5% të eksporteve totale të Shqipërisë


Grafiku 1: Peshë e eksporteve dhe importeve industriale në BE ndaj totalit të eksporteve dhe importeve industriale të Shqipërisë,



Burimi: ACIT, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Eksportet kryesore të Shqipërisë në BE, në termat e sektorëve (HS 2-shifror), janë veshjet e këmbëve (faqet e sipërme të këpucëve nën regjimin e përpunimit aktiv), artikuj të veshjes së trupit (gjithashtu nën regjimin e përpunimit aktiv), koks dhe bitum naftë, ferro-lidhjet, mbetje e alumini i papërpunuar, lëkura dhe druri. Eksportet me origjinë nga Shqipëria janë në vlerë minimale, ndërkohë që ato nën përpunimin aktiv zënë pjesën dominante të portofolit (shih Grafiku 2). Konçensionet e dhëna nga BE për eksportin e produkteve shqiptare industriale në BE gjatë këtyre viteve (siç janë përshkruar në seksionin e mëposhtëm) nuk janë shfrytëzuar.

Grafiku 2: Portofoli i eksporteve të mallrave industriale në BE, 2003




Burimi: ACIT, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Ndërkohë importet nga BE paraqiten më të shumëllojshme, si rezultat i nevojave konsumatore e industriale për një gamë të gjerë produktesh dhe lëndësh të para që nuk prodhohen në vend. Është e rëndësishme të veçojmë zërat e makineri-pajisjeve dhe mjeteve të transportit, të cilat në vitet e fundit kanë variuar nga 16-26% të importeve

totale, duke përfaqësuar kështu vlera të rëndësishme të investimeve në sektorë të ndryshëm.

Grafiku 3: Portofoli i importit të mallrave industriale nga BE, 2003



Burimi: ACIT, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Nëse do të ndaleshim në nivele akoma më të detajuara të produkteve kryesore industriale (HS 6-shifror) që ka eksportuar Shqipëria, veshjet e këmbëve do të kryesonin listën, të ndjekura nga ferro-kromi dhe këmishat për meshkuj. Vihet re se avantazhet krahasuese që secili nga produktet e listuara në Tabelën 1, shfaq në mardhëniet tregtare me vende të ndryshme, janë të ndryshme dhe të luhatura gjatë viteve për disa prej tyre. Kështu, Shqipëria ka një avantazh të qëndrueshëm krahasues me Italinë për suprinat e këpucëve, akoma më të mirë me Gjermaninë dhe në rënie deri në disavantazh të theksuar me Greqinë. Avantazhe krahasuese të theksuara shfaqen edhe për pantallonat me Gjermaninë, ferr-kromin me Italinë dhe Gjermaninë, këmishat e meshkujve me Gjermaninë, veshjet e brendshme me Italinë dhe bluzat e këmishat e femrave me Gjermaninë, Anglinë dhe Austrinë.

Tabela 1: Avantazhet krahasuese të shfaqura për produktet industriale (HS 6-shifror) më të eksportuara të Shqipërisë, 2003

Kodi HS	Përshkrimi	Vendet ku eksportohen	2003	2002	2001	2000
			RCA ²	RCA	RCA	RCA
640610	Suprinat e këpucëve	Greqi	-0.479	-0.703	0.101	0.091
		Itali	0.445	0.347	0.371	0.477
		Gjermani	1.000	0.883	1.000	1.000
		Francë	1.000		0.147	-0.935
620342	Pantallona/Kominoshe prej pambuku	Greqi	-0.347	0.259	-0.017	-0.677
		Itali	0.234	0.348	0.275	1.000
		Gjermani	0.961	0.925	0.696	0.965
720241	Ferro-krom që përmban ndaj peshës me shumë se 4% karbon	Itali	1.000	1.000	1.000	1.000
		Gjermani	1.000		1.000	1.000
620520	Këmisha meshkujsh prej pambuku	Greqi	0.433	0.116	0.205	0.148
		Itali	0.060	0.193	0.224	0.330
		Gjermani	1.000	-0.072	0.954	1.000
830160	Pjesët e drynave dhe kyçeve prej metali bazë	Greqi	-1.000	1.000	-1.000	-1.000
		Itali	-0.305	-0.013	-0.121	0.153

² Avantazhi krahasues i shfaqur (diferenca e eksportit me importin e një produkti pjesëtuar me shumtaren e eksportit dhe importit të atij produkti). -1 tregon disavantazhin maksimal dhe 1 tregon avantazhin maksimal.

610821	Veshje të brendshme prej pambuku	Greqi	0.381	0.841	0.898	0.867
		Itali	0.074	0.130	0.196	0.263
620690	Bluza e këmisha femrash prej lini ose kerpi	Greqi	-0.626	-0.795	-0.013	-0.115
		Itali	0.516	0.881	0.490	0.264
		Gjermani	0.999	0.997	1.000	1.000
		UK	1.000	-1.000	1.000	1.000
		Austri	0.960	-1.000	1.000	0.612
		Danimarkë		1.000		
		Belgjikë	1.000		1.000	1.000

Burimi: ACIT, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

3. Kuadri ligjor i tregtisë së mallrave industriale me BE

Tregtia e produkteve industriale me BE është rregulluar në vite nga një varg marrëveshjesh e rregulloresh të BE. Fillimi i kësaj tregtie daton në fillim të viteve '90 pas rënies së sistemit të centralizuar ekonomik dhe hapjes së tregjeve. Më konkretisht, disa nga dokumentet më të rëndësishme që i referohen rregullimit të mardhënieve tregtare me BE (përshi produktet industriale) janë si më poshtë:

- Marrëveshja ndërmjet Komunitetit Ekonomik Evropian dhe RSH mbi bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik (Fletore Zyrtare e EEC L. 343, 25/11/1992). Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje ishte që palët t'i jepnin njëra-tjetrës trajtimin e Kombit Më të Favorizuar dhe dhënien e shkallës më të lartë të liberalizimit që secila palë ka me palë të treta (përjashtim bënin produktet e tekstit të Seksionit XI të HS dhe produktet e traktatit të Komitetit të Qymyrit dhe Çelikut Evropian). Marrëveshja gjithashtu hoqi kufizimet sasiore si edhe rregulloi aspekte të tjera të tregtisë dypalëshe.
- Menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes së sipërpërmendur, Komisioni nxorri një rregullore (Nr. 3917/1992 në 21/12/1992) në bazë të të cilës Shqipëria iu shtua vendeve në zhvillim të cilat përfitonin nga Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave Tarifore për Produktet e Tekstit që BE i akordonte vendeve në zhvillim për produktet me origjinë nga këto vende. Në bazë të këtij sistemi, Shqipëria mund të eksportonte në BE brenda kuotave të përcaktuara pa tarifë doganore.
- Preferenca Autonome Tregtare iu akorduan Shqipërisë për produktet industriale në 29/07/1999, me rregulloren Nr. 1763, BE, duke shfuqizuar ato të ofruara nga Sistemi i Përgjithshëm Preferencial për vendet në zhvillim. Preferencat autonome kishin të bënin me eksportin e disa produkteve si veshje, këpucë, superfosfati, ferro-kromi dhe alumini e skrapi me tarifa doganore 0 brenda kuotave të caktuara për Shqipërinë. Këto kuota ishin të ndara në kuota për produktet nën regjimin e përpunimit aktiv dhe kuota për produktet me origjinë shqiptare. Ndërkohë, regjimi i produkteve të kapitullit 72 (giza dhe çeliku), përveç ferro-kromit (720241) vazhdoi të trajtohej nga Traktati ECSC, pra produkte të përjashtuara nga preferencat tarifore (shih Rregulloren e KE 2820/98),
- Rregullorja e KE Nr. 2007, i ofroi Shqipërisë në 18/09/2000 preferenca asimetrike rajonale, në kuadrin e procesit të Stabilizim-Asocimit me BE të vendeve të rajonit. Kjo rregullore shfuqizoi Rregulloren 1763/99 të sipërpërmendur, përjashtoi përfundimisht Shqipërinë nga GSP, dhe akordoi hyrjen e lirë të mallrave industriale me origjinë shqiptare në tregun e BE. Për

këtë arsye edhe sistemi u quajt asimetrik, sepse Shqipëria ende nuk lejonte në atë kohë lëvizjen e mallrave evropiane në atë shkallë lirie tarifore sa BE ofronte për produktet shqiptare. Kjo rregullore kufizonte vetëm eksportin e produkteve të tekstitit, të cilat mund të eksportoreshin me tarifë 0 vetëm brenda disa kuotave të përcaktuara në Rregullore 517/94. Në këtë rregullore përcaktoreshin kuota të ndryshme për tekstilet me origjinë shqiptare dhe tekstilet nën regjimin e përpunimit aktiv, kuota të cilat ishin të përbashkëta me Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë dhe Maqedoninë, Supozohej që këto vende do të viheshin në garë për të përfutuar nga kjo kuota, ndërkohë që regjimi asimetrik për mallrat industriale nuk është shfrytëzuar sa duhet nga Shqipëria dhe vendet e sipërpërmendura, aq më pak për produktet me origjinë shqiptare.

4. MSA: nje skenar i ri i tregtisë së mallrave industriale me BE

MSA parashikon të liberalizojë plotësisht tregtinë e produkteve industriale në mënyrë të dykrahshme. Regjimi tregtar, nga një regjim asimetrik do të shndërrohet në një regjim simetrik, ku jo vetëm BE akordon lirinë e eksporteve shqiptare në BE, por edhe Shqipëria do të akordojë hyrjen pa tarifa të mallrave evropiane në Shqipëri. Simetria në treg përbën edhe thelbin e ndryshimit nga regjimi aktual në pjesën mbi lëvizjen e mallrave në MSA. Liberalizimi do të jetë i plotë për të dyja palët, përveç një liste mallrash me origjinë nga BE, tarifatat doganore të të cilave Shqipëria do t'i reduktojë gradualisht drejt zeros deri në 1 janar 2009. Ky moment përkon me kohën e harmonizimit të afateve kohore të liberalizimit të plotë të mallrave të nënshkruara në MTL-të me vendet e rajonit, duke synuar kështu krijimin e një zone të tregtisë së lirë në 2009, kusht ky i vendosur nga BE në Memorandumin e Mirëkuptimit për Tregtinë e Lirë në 27 qershor 2001, nënshkruar nga vendet e rajonit.

Raundi i negociatave për produktet industriale ka përfunduar tashmë. Mallrat industriale të propozuara nga pala shqiptare për mbrojtje të përkohshme, mendohen të realizojnë:

- nxitjen e prodhimit dhe investimit në sektorë të caktuar
- sigurimin e të ardhurave buxhetore për qeverinë

Më konkretisht, këto mallra përfshijnë: klasën e produkteve të çimentos (2325), naftë dhe karburante të tjera (shumë produkte të kapitullit 27), artikuj kozmetike e detergjentë (disa produkte të kapitujve 33 dhe 34), një tip kutie kartoni, artikuj të veshjeve të këmbëve, tulla e tjegulla, artikuj të gizës e çelikut, bakrit dhe artikuj mobilerie. Reduktimi tarifor i këtyre mallrave do të bëhet në mënyrë të shkallëzuar sipas shkallës: ditën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes reduktim deri në 80% të tarifës bazë, në 1 janar 2005, reduktimi do të jetë deri në 60% të tarifës bazë, 1 janar 2006 në 40%, 1 janar 2007 në 20%, 1 janar 2008 në 10% dhe në 1 janar 2009 tarifatat doganore të këtyre mallrave do të hiqen fare.

Gjithashtu, MSA parashikon edhe heqjen e çdo kufizimi sasior apo çdo mase tjetër ekuivalente mbi importin dhe eksportin e mallrave industriale në tregtinë me BE.

Marrëveshja parashikon gjithashtu një protokoll të veçantë mbi produktet e gizës dhe çelikut, në bazë të së cilës disa nga këto produkte që do të importohen në Shqipëri me

originë nga BE do të kenë mbrojtje të përkohshme tarifore. Ndërkohë, produktet e mbuluara nga Traktati që themeloi Komunitetin Evropian të Energjisë dhe Atomit do të mbulohen nga ky traktat.

Reduktimet tarifore do të bëhen mbi tarifën MFN sipas skedulit të angazhimeve që Shqipëria ka me OBT. Për disa nga produktet e përfshira në MSA për reduktim të shkallëzuar, (produkte të kapitullit 94), angazhimi në OBT është që të bëhen 0 në 2007, rrjedhimisht nuk mund të ketë mbrojtje të tyre në tregtinë me BE gjatë periudhës 2007 – 2009.

Nisur edhe nga eksperiencia me MSA ndërmjet BE-Maqedoni, pritët që BE t'i kërkojë Shqipërisë që këto angazhime për reduktimet e shkallëzuara të disa produkteve industriale, të realizohen në një kohë më të shpejtë sesa angazhimi i shprehur, nëse kushtet e ekonomisë dhe të sektorit përkatës do ta lejonin një gjë të tillë.

5. Rregullat e origjinës: kusht për t'u trajtuar si i preferuar në BE

Koncepti i rregullave të origjinës së mallit është një koncept që mund të gjendet në shumë marrëveshje preferenciale që vendet i japin njëri-tjetrit. Rregullat e origjinës garantojnë që produktet e tregtuara mes palëve që përfitojnë nga regjimi i liberalizuar tregtar i rënë dakord në marrëveshje, të jenë realisht produktet e palëve dhe jo të vendeve të tjera. Për shkak të nevojës së kësaj garancie, palët bien dakord për rregullat që kanë të bëjnë me origjinën e mallrave që do të përfitojnë nga marrëveshjet preferenciale.

Kodi doganor i RSH tashmë i përafëruar me atë të BE ka adoptuar shumë nga dispozitat përkatëse në lidhje me rregullat e origjinës, megjithatë protokollin e MSA mbi rregullat e origjinës tashmë i negocuar, parashikon disa dispozita të veçanta të cilat duhet të parashikohen në Kodin Doganor apo aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Kështu, rregullat e origjinës në draftin e MSA ndërmjet BE dhe RSH si edhe në KD të RSH (neni 47(2) i DZKD) njohin produktin me origjinë nga pala përkatëse, nëse:

- a. Ai është përftuar plotësisht në vendin përkatës
- b. Ai është përpunuar pjesërisht, por mjaftueshmërisht, sipas kushteve të caktuara mbi shkallën e përpunimit.

Përsa i përket a:

Produktet e përftuara plotësisht në vend janë ato të parashikuara në nenin 48(1) të DZKD të RSH. Ato përfshijnë të gjitha ato produkte që vijnë nga burimet ujore, nëntokësore, shtazore, etj, pra ato produkte që kanë si të përbashkët faktin që asnjë proces përpunimi nga dora e njeriut nuk është kryer mbi to.

Shembull: një mineral i nxjerrë nga nëntoka shqiptare merr automatikisht statusin e origjinës nga Shqipëria.

Përsa i përket b:

Produktet e përpunuara pjesërisht që përfitojnë statusin origjinues, në kuptimin e MSA, nënkuptojnë që disa përpunime janë kryer mbi produktin, të tilla që vlera e

materialeve jo-origjinuese (materiale që nuk kanë origjinë shqiptare), (i) si rregull i përgjithshëm: të mos kalojë 10% të çmimit *ex-works* (çmimi që ka përpunuesi i fundit i produktit, pasi i janë zbritur taksat, dhe (ii) si rregull specifik: të mos kalojë një vlerë sipas kushteve të përcaktuara në një aneks të posaçëm ku listohen produktet dhe shkalla e proçeseve të përpunimit që ato duhet të kalojnë.

Shembull: një lingotë që ka origjinë jo-shqiptare, është përpunuar në Shqipëri dhe ka rezultuar në një përzierje çeliku të shkrirë (7224). Proçesi i shkrirjes në Shqipëri, në bazë të kushtit të vendosur si rregull specifik në aneksin e posaçëm të MSA, e bën 7224 automatikisht produkt me origjinë shqiptare. 7224 mund të përdoret si lëndë e parë për prodhimin e një motorri (8407). Rregulli i vendosur për 8407 që të fitojë origjinë shqiptare është që vlera e materialeve jo-origjinuese që mund të trupëzohen në të nuk mund të kalojë masën prej 40% të çmimit *ex-works*. Nëse çeliku i mësipërm (7224) do të përdorej për prodhimin e këtij motorri, atëherë motorri përfiton origjinë shqiptare, pra edhe status preferencial në BE.

Marrëveshja parashikon disa proçese përpunimi të cilat nuk konsiderohen të mjetueshme që produkti të përfitojë statusin origjinues (si psh: operacione që kanë për qëllim ruajtjen gjatë transportit dhe magazinimit, operacione pastrimi, klasifikimi, ndryshimi i ambalazheve, ambalazhimi, vendosja e etiketave, montimi i thjeshtë i pjesëve të një produkti, therrja e bagëtive, etj raste të parashikuara edhe në DZKD, neni 49(3).

Dy koncepte të rëndësishme në marrëveshjet preferenciale janë kumulimi bilateral dhe ai diagonal. Kumulimi bilateral në draftin e MSA njeh që materialet me origjinë nga BE, nëse pësojnë një transformim në Shqipëri (përtej transformimeve minimale të përmendura në paragrafin e mësipërm), fitojnë origjinë shqiptare. E njëjta gjë vlen edhe për mallrat shqiptare që pësojnë transformime në BE. Pra, në kuadrin e kësaj marrëveshjeje preferenciale, në origjinën e mallit akumulohet edhe vlera e mallrave me origjinë nga pala partnere.

Shembull: nëse nga Italia importohet lëkurë me origjinë nga BE, pritët, qepet dhe paketohet në Shqipëri, atëherë vlera e lëkurës me origjinë nga BE i shtohet vlerës së produktit final (këpuçës) dhe këpuca merr origjinë shqiptare. Por nëse lëkura vjen e prerë, dhe vetëm montimi i pjesëve bëhet në Shqipëri, atëherë, siç u përmend edhe në paragrafin e mësipërm, transformimi është i pamjaftueshëm për të fituar origjinë shqiptare.

Ndërkohë kumulimi diagonal i referohet njohjes së origjinës nëse materialet ose përpunimet e një produkti janë kryer në një vend të tretë me kusht që të tre vendet kanë marrëveshje preferenciale me njëri-tjetrin. Koncepti do të ketë vlerë pas përfundimit të skeduleve kohore të reduktimeve tarifore që vendet e rajonit kanë nënshkruar me njëra-tjetrën, reduktime të cilat do të cojnë në krijimin e një zone të lirë tregtare me rregulla tregtare të harmonizuara me ato të BE. Aktualisht, marrëveshjet e tregtisë mes vendeve të rajonit parashikojnë rregulla të harmonizuara të origjinës, të cilat stimulojnë shkëmbimet tregtare ndërmjet këtyre vendeve në përpjekjet për hyrjen e tyre në tregun evropian.

Shembull: nëse lëkura importohet nga Maqedonia, përpunohet në Shqipëri dhe eksportohet në BE, vlera e lëkurës nga Maqedonia do të njihet si origjinuese dhe lëkura e përpunuar merr status preferencial (hyn me tarifë zero) në BE.

Për të vërtetuar origjinën e mallit, MSA prashikon një procedurë sipas së cilës eksportuesi duhet të dorëzojë ose një certifikatë EUR.1 ose një deklaratë faturore. Për secilin nga dokumentat, janë parashikuar kushtet e marrjes, forma dhe dispozita të tjera përkatëse.

Certifikata EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore sipas kërkesës me shkrim të bërë nga eksportuesi apo përfaqesuesi ligjor i tij. Formulari i EUR.1 dhe i kërkesës është i gatshëm pranë autoriteteve doganore dhe plotësohet nga eksportuesi me të dhënat mbi produktin dhe pyetjet e tjera në formular. Në çdo kohë, eksportuesi duhet të jetë i gatshëm të ofrojë informacionet dhe dokumentacionin e duhur që provon origjinën e mallit të tij, nëse i kërkohen nga autoritetet doganore. Në këtë kuptim, autoritetet doganore kanë të drejtë të ndërmarrin çdo lloj inspektimi të llogarive të eksportuesit ose kontrole të tjera, si edhe kontrollin e plotësimit të saktë të formularëve. EUR.1 mund të lëshohet në momentin e eksportimit të mallit ose pas eksportimit të tij (nëse nuk ka qenë i mundshëm lëshimi i saj në kohën e duhur për shkak gabimeve apo rrethanave të caktuara, ose për shkak të mospranimit të saj nga dogana importuese për arsye teknike, raste në të cilat lëshohet një certifikatë *a posteriori* – ose *issued retrospectively*).

Deklarata faturore mund të përdoret në rastin e eksportuesit të aprovuar³ ose nga një eksportues për dërgesa që nuk e kalojnë vlerën 6,000 Euro. Teksti i një deklarate të tillë është i gatshëm dhe i vendosur si aneks në MSA. Eksportuesi duhet të shtypë këtë tekst mbi faturën, dokumentin tregtar apo atë të lëvrimin të mallit. Ai gjithashtu duhet të jetë i gatshëm të ofrojë të gjithë dokumentacionin e duhur që vërteton origjinën e mallit, nëse autoritetet doganore ia kërkojnë këtë gjë. Deklarata duhet të ketë nënshkrimin origjinal të eksportuesit. Megjithatë, eksportuesi i aprovuar nuk ka nevojë të nënshkruajë këtë deklaratë, sepse ai ka dorëzuar në momentin e marrjes së aprovimit, një deklaratë me shkrim për përgjegjësinë e tij të plotë për çdo deklarate faturore.

Dokumentet shtesë që mund të kërkohen për verifikimin e origjinës së mallit mund të përfshijnë: (i) dokumente të kontabilitetit që vërtetojnë proceset prodhuese që kanë ndodhur, (ii) dokumente që vërtetojnë origjinën e materialeve të përdorura, nëse ato janë konform ligjeve. Eksportuesi duhet t'i ruajë për të paktën tre vjet dokumentet e EUR.1 apo deklaratën faturore dhe të gjitha dokumentet që vërtetojnë origjinën e mallit. Nga ana tjetër, edhe autoriteti doganor në vendin e eksportit do të ruajë për të paktën tre vjet formularin e kërkesës që dorëzon eksportuesi për nxerrjen e dokumentit të origjinës dhe ai i vendit importues, do të ruajë po për të paktën tre vjet certifikatën EUR.1 dhe deklaratën faturore që i është dorëzuar nga importuesi.

Dokumenti i origjinës do të jetë i vlefshëm katër muaj nga momenti i lëshimit të tij në vendin eksportues dhe mund t'i paraqitet autoritetit doganor në vendin importues vetëm brenda kësaj periudhe. Çdo vend anëtar i BE ka rregullat përkatëse në importin e mallrave me origjinë preferenciale, rregulla të cilat mund të kërkojnë që dokumenti që vërteton origjinën të jetë në gjuhën e vendit importues, apo importuesi të bashkëngjisë një deklaratë se mallrat plotësojnë kushtet e kërkuara nga marrëveshja e

³ Biznese që eksportojnë shpesh dhe që u është dhënë nga autoriteti doganor një numër autorizimi doganor për monitorim

Shqipërisë me BE. Marrëveshja parashikon edhe dispozita të tjera të veçanta mbi rregullat e origjinës.

6. Standartet e cilësisë: kusht për të qenë i pranishëm në tregun e BE

Standartet janë aspekte të rëndësishme të produktit. Ato e bëjnë produktin cilësor, të përshtatshëm për pajisjet e tjera që disponohen, të besueshëm ose jo-të rrezikshëm për jetën dhe shëndetin. Në ligjin për Standartizimin ai përkufizohet si një specifikë teknike, e miratuar nga organizmi kombëtar i standartizimit, i detyrueshëm dhe që shërben si dokument për arritjen e nivelit të caktuar të cilësisë. Përfitimet nga konformiteti me standartet janë shumëplanëshe dhe për shumë palë të shoqërisë, siç paraqiten edhe në Kutinë 1.

Kutia 1: Përfitimet nga Standartet

Përfitimet nga standartet:

Për bizneset: adoptimi i gjerë i standarteve ndërkombëtare do të thotë që furnitorët i kanë bazuar produktet dhe shërbimet e tyre në specifikime teknike që janë të pranuar nga publiku i gjerë, rrjedhimisht edhe produktet e tyre priten të jenë të pranuar nga publiku. Kjo i jep atyre lirinë për të konkurruar në tregje të ndryshme të botës.

Për klientet: produktet dhe shërbimet e prodhuara me standarte ndërkombëtare u jep atyre mundësinë e zgjedhjes mes një game të gjerë mallrash si edhe përfitime në çmime për shkak të konkurrencës ndërmjet ofruesve të tyre.

Për qeveritë: standartet ndërkombëtare janë baza teknologjike dhe shkencore e legjislacionit shëndetësor, të sigurisë dhe të mjedisit.

Për zyrtarët e tregtisë: gjatë negociatave për tregje rajonale dhe globale, prezenca e standarteve ndërkombëtare, krijon një lojë në kushte të barabarta “*level-play field*” ndërmjet konkurrentëve në ato tregje. Ndërkohë që prezenca e standarteve të ndryshme do të krijonte barriera teknike tregtare, edhe pse kuotat mund të hiqeshin. Pra, standartet janë mjete teknike me anë të të cilave mund të vihen në praktikë vendimet dhe marrëveshjet politike tregtare.

Për vendet në zhvillim: standartet përbëjnë një burim të rëndësishëm të transferimit të “know how”. Standartet ndërkombëtare, duke përcaktuar karakteristikat e produkteve dhe shërbimeve për eksport në tregjet e huaja në të njëjtën kohë alokojnë edhe burimet.

Për konsumatorët: konformiteti me standartet ndërkombëtare jep garanci për cilësinë, sigurinë dhe besueshmerinë e produkteve dhe shërbimeve.

Për publikun e gjerë: standartet ndërkombëtare kontribuojnë në cilësinë e jetës në përgjithësi duke garantuar sigurinë e transportit, makinerive dhe mjeteve që përdoren.

Për planetin ku jetojmë: standartet ndërkombëtare për derdhjet e gazrave dhe rrezatimin në ajër, ujë, tokë, kontribuojnë në përpjekjet tona për ruajtjen e mjedisit në planet.

Burimi: Organizata Ndërkombëtare e Standarteve (ISO)

Organizmi kryesor ndërkombëtar i standartave është Organizata Ndërkombëtare e Standarteve (ISO). Ajo është një organizatë jo-qeveritare ku aderojnë si anëtarë institutet kombëtare të standarteve nga vende të ndryshme. Shqipëria, si një vend me një sistem jo plotësisht të zhvilluar të standarteve, nuk është një anëtare me të drejta të plota, por një anëtare korrespondente, që do të thotë, që nuk ka të drejtë vote, paguan një tarifë më të ulët anëtarësie dhe mbahet vazhdimisht e informuar për aktivitetet dhe të rejat e organizatës. Përveç, ISO egziston edhe IEC (Komisioni Ndërkombëtar i Elektroteknikës) dhe ITU (Unioni ndërkombëtar i Telekomunikacionit), që përfaqësojnë tre organizmat më të mëdhenj ndërkombëtarë të standarteve. Këto institucione punojnë në partneritet të ngushtë me OBT me qëllimin madhor të promovimit të një sistemi tregtar të lirë dhe të ndershëm. Në këtë kuptim, marrëveshja TBT e OBT përbën një marrëveshje politike, e cila mbështetet me aspekte teknike nga tre organizmat e sipërpërmendur.

ISO ka zhvilluar një game standartesh, por më të suksesshmet dhe më të njohurat janë ISO 9000 dhe ISO 14000. E para merret me “manaxhimin e cilësisë”, që do të thotë tërësia e veprimeve që bën organizata për të plotësuar kërkesat e klientëve dhe kërkesat ligjore të produktit si edhe përmirësimet e vazhdueshme të performancës së saj me synimin final që klienti të mbetet i kënaqur. ISO 9000 është shndërruar në një referencë cilësie në komunikimin ndërmjet bizneseve. Nga ana tjetër, ISO 14000 merret me “manaxhimin mjedisor”, që do të thotë tërësia e veprimeve që bën organizata për të minimizuar efektet e dëmshme të veprimtarisë së saj mbi mjedisin si edhe përmirësimet e vazhdueshme që ajo i bën performancës së saj mjedisore. Për më shumë rreth ISO 9000 dhe ISO 14000 mund të konsultoni www.iso.org ose të kontaktoni Drejtorinë e Përgjithshme të Standarteve.

Në BE standartet janë marrëveshje vullnetare të dokumentuara që vendet bëjnë me BE edhe që përcaktojnë kritere të rëndësishme për produktet, shërbimet dhe proceset. Ato garantojnë që produktet, shërbimet dhe proceset i përgjigjen qëllimit për të cilin janë krijuar, janë të krahasueshme dhe përputhen me sistemet e tjera të përdorimit. Ato janë të njëjta me standartet ndërkombëtare, por që të njihen si evropiane ato duhet të adoptohen prej një prej organizatave evropiane të standarteve dhe të jenë publike.

Organizatat kryesore të standartave evropiane janë:

- CEN – Komiteti Evropian për Standartet, i themeluar në 1961 nga institutet kombëtare të standarteve. Ai merret me hartimin e standarteve të të gjithë sektorëve përveç elektroteknikës dhe telekomunikacionit. Shqipëria dhe disa vende të tjera të Ballkanit janë anëtare të afiluara, pra që synojnë të bëhen anëtare më të drejta të plota nëse përmbush kriteret përkatëse. Si anëtare e afiluar, Shqipëria merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme, në trupat teknikë të organizatës si edhe merr të gjithë dokumentacionin teknik dhe të përgjithshëm të organizatës. Pjesëmarrja në këtë organizatë zvogëlon barrierat tregtare, promovon sigurinë, lejon lëvizjen e mallrave, sistemeve dhe shërbimeve, dhe promovon mirëkuptimin teknik ndërmjet vendeve anëtare. Standartet që hartohen në këtë organizatë janë rezultat i punës vullnetare të anëtarëve, interesat e të cilëve përfaqësohen nga Instituti Kombëtar i Standarteve. Draftet e standarteve bëhen publike përpara miratimit të tyre përfundimtar. Miratimi bëhet me votim të përgjithshëm nga anëtarët. Çdo standart evropian shndërrohet në standart kombëtar dhe çdo standart kombëtar që bie ndesh me standartin evropian shfuqizohet. Aktualisht Shqipëria ka adoptuar 45% të standarteve evropiane si standarte kombëtare dhe parashikohet që deri në vitin 2008 të arrihet në 80% sipas vullnetit për të adoptuar ato standarte që ndihmojnë në rritjen e cilësisë së produktit. Angazhimi për përafrimin e standarteve dhe aspekteve të tjera të lidhura me to është parashikuar edhe në MSA.
- CENELEC – Komiteti Evropian për Standartizimin Elektroteknik, merret me standartet në fushën e elektroteknikës. I themeluar në 1973, ai operon në mënyrë të ngjashme me CEN në hartimin e standarteve vullnetare në sektorin e elektroteknikës. Edhe këtu Shqipëria është një anëtare e afiluar.
- ETSI – Instituti Evropian i Standarteve të Telekomunikacionit, mbulon aspekte të standarteve në telekomunikacion dhe transmetim televiziv. Shqipëria është në rolin e vëzhgueses.

Standartet evropiane janë mjete të fuqishme për të rritur konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve në BE. Metoda e re e Standartizimit në BE synon të japë direktiva të përgjithshme mbi kërkesat e sigurisë dhe jo detaje teknike të standarteve. Është biznesi ai i cili bazuar mbi direktivën e përgjithshme, zhvillon standartet në një nga organizatat evropiane të sipërpërmendura. Proçesi është transparent (shih www.newapproach.org) dhe kalon në një proçes pjesëmarrës dhe konsultimi publik. Këto standarte njihen si standarte të harmonizuara dhe njihen konform direktivës në zbatim të të cilës ato u ndërtuan. Siç edhe mund të shihet në rastin e sektorit të lëkurë/këpucëve standartizimi është në thelb një iniciativë e përbashkët e biznesit, i cili duke synuar përfitimet që vijnë nga ligjet për standartizimin, diskutojnë bashkërisht dhe me rrethet shkencore e profesionale për hartimin e standarteve. Forumi më i mirë është organizata e standarteve. Standartet pra janë rezultat i një eksperience shumë-vjeçare të të punuarit në një sektor të caktuar dhe në këtë kuptim, ashtu si edhe për shumë praktika të tjera më të mira në BE, Shqipërisë dhe veçanërisht biznesit shqiptar i mbetet kryesisht t'i mësojë dhe zbatojë ato nëse synojnë hyrjen në tregun e BE.

Kutia 2: Standartet evropiane në sektorin e këpucëve

Standartet evropiane në sektorin e këpucëve

Në BE nuk ka standarte për veshjet e këmbëve, përveç veshjeve të këmbës së sigurisë së lartë (profesionale). Tregjet e vendeve anëtare të BE punojnë me kërkesa të ndryshme përsa i përket cilësisë, materialeve, masave, ngjyrave, etj. Në këtë kuptim, operatorët e këtij sektori në BE kanë vendosur me njëri-tjetrin vetëm disa kërkesa minimale të cilësisë, të testuara me metoda të rregullura me ligj për secilin vend anëtar. Kështu, këto metoda specifikohen në Gjermani nga organizata e standarteve DIM, në Francë nga AFNOR, në Hollandë nga NEN, në Angli nga BS, etj. Aktualisht CEN dhe ISO po punojnë bashkërisht në hartimin e standarteve për një politikë të “*cilësisë së plotë*” nëse bizneset e dëshirojnë këtë gjë. Kështu dokumenti CEN/TC309 ka draftuar standartet për metodat e testimit, terminologjinë dhe kërkesat e performancës për komponentët e veshjeve të këmbës dhe këpucëve të përfunduara, si dhe për impaktet mjedisore të prodhimit të tyre. ISO/TC 216 po punon që ta shtrijë CEN/TC 309 në mbarë botën. Paralelisht me këtë dokument, tashmë egzistojnë edhe dy dokumente të tjerë: ISO/TC 94 për këpucët profesionale dhe ISO/TC 137 për sistemin e masave, dizenjimin dhe markimin e këpucëve dhe çizmeve.

Në sektorin e këpucëve për fëmijë, industria evropiane e këpucëve po punon ngushtë me rrethet mjekësore e shkencore në njohjen e kërkesës së konsumatorëve me qëllim identifikimin e këpucëve të cilësisë së lartë e pa probleme shendetësore.

Burimi: Organizata Ndërkombëtare e Standarteve (ISO)

Për një njohje më të thellë të standarteve për produkte, shërbime apo proçese të caktuara, mund të drejtoheni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Standarteve, e cila është përfaqësuesja e Shqipërisë në organizatat evropiane të standarteve.

7. Informimi

Por ajo që kurorëzon produktin tuaj me statusin e shitjes në tregun e BE është aftësia e tij për të qenë konkurrues. Njohja e karakteristikave të tregut ku synohet të hyhet është vendimtare përpara ndërmarrjes së prodhimit të një produkti apo shërbimi. Për më shumë informacion mbi tregjet evropiane në sektorin e veshjeve, këpucëve, dhe drurit mund të kontaktoni ACIT. Këto informacione përmbajnë të dhëna mbi

madhësinë e këtyre tregjeve në BE, termat e tregtisë, të pagesës dhe lëvrimit, kanalet e shpërndarjes, barrierat teknike për hyrjen në këto tregje, kontakte, etj.